

RREGULLOJA NR. 2007/23

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2004/52
MBI TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999) mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar me kërkesën e Qeverisë dhe duke u konsultuar me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/52 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për të ndryshuar përkufizimin e njësisë së përhershme,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshim

1.1 Përkufizimi i “njësisë së përhershme” në Nenin 1(N) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/52 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale do të zëvendësohet me përkufizimin vijues:

“(n) “Njësi e përhershme” ka kuptimin që i është dhënë me nenin 1A të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;”

Neni 2

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 gusht 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm